



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Zyra e Auditorit Gjeneral/Kancelarija Glavnog Revizora

AUDITIMI FINANCIAR

KOMUNA E MALISHEVËS

PASQYRAT FINANCIARE

**PËR VITIN QË PËRFUNDON MË
31 DHJETOR 2007**

Prishtina, Dhjetor 2008

LETËR DORËZIMI

Datë: 26.12.2008

Për: Z. Isni Kilaj

I nderuar Z. Kilaj,

Ky është raporti ynë final mbi rezultatet e auditimit nga Zyra e Auditorit Gjeneral të pasqyrave financiare të Komunës së Malishevës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007. Në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/33, ky raport do të bëhet publik.

Raporti ynë përmban rekomandimet për veprimet tuaja. Rregullorja 2005/33, Neni 1 B. (e) kërkon që brenda 30 ditëve të publikimit të raportit tonë të auditimit, ju duhet të parashtroni një raport që tregon se si institucioni juaj do të implementoj këto rekomandime. Rapoti juaj pritet më 30 Janar 2009.

E vlersojmë bashkëpunimin dhe mirësjelljen e ofruar stafit tonë gjatë auditimit. Zyra e Auditorit Gjeneral mirëpret bashkëpunimin me ju në të ardhmen në auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2008.

Me nderime,

Linda Casella
Auditor Gjeneral

PËRMBAJTJA

I.	Përmbledhje e Përgjithshme	5
II.	Parathënie	6
III.	Status i Rekomandimeve të Auditorit nga Vitet e Mëhershme	7
IV.	Fushveprimi i Auditimit	12
V.	Mendimi i auditorit	13
VI.	Çasja e Auditimit	15
VII.	Të gjeturat Kyqe dhe Rekomandimet	17

Shtojcë

- I. Komuna e Malishevës
Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007
- II. Komentet e Menaxhmentit të Komunës

Lista e Shkurtesave dhe Akronimeve

AGJ	Auditori Gjeneral
UA	Udhëzimi Administrativ
OE	Operatori Ekonomik
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
ZAGJ	Zyra e Auditorit Gjeneral
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
SE	Sigurimi i Ekzekutimit
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Zyra e Auditorit Gjeneral ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Malishevës (më tej referuar si “Komuna”) për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.

Për shkak të çështjeve të diskutuara në Pjesën V: Mendimi i auditorit ne nuk ishim në gjendje të japim dhe ne nuk japim një mendim mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007.

Të gjeturat dhe rekomandimet e ndërlidhura janë paraqitur përbrenda Pjesës VII të raportit. ZAGJ nxit Manaxhmentin e Lartë të Komunës të ndërmarrë veprime korigjuese mbi këto rekomandime dhe para kësaj të paraqesë një Plan Veprimi për shqyrtimin e këtyre rekomandimeve 30 ditë nga pranimi i Raportit Final të Auditimit

II. PARATHËNIE

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/18, datë 4 Tetor 2002, ka themeluar Zyrën e Auditorit Gjeneral (ZAGJ) në Kosovë. Sipas Nenit 3.2 të kësaj rregullore, nga Auditori Gjeneral (AG) kërkohet të kryejë auditim për çdo vit të të gjitha institucioneve të Kosovës që të përcaktojë:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pasqyrë të saktë dhe të drejtë;
- Nëse shënimet financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme;
- Përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme dhe funksioneve të auditimit të brendshëm;
- Ndërshmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të ndërmarra përbrenda institucioneve apo entiteve të audituara; dhe
- Të gjitha çështjet që dalin ga auditimi ose që ndërlihen me të.

Në Mars 2003, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin Nr. 2003/2 “Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” që është miratuar zyrtarisht nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) më 12 Maj 2003 me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/17. Neni 42 i Ligjit deklaron se AGJ do të përgatisë dhe t’i dorëzojë Kuvendit dhe PSSP-së një raport mbi deklaratat financiare të organizatave buxhetore për vitin e kaluar fiskal ku do të parashtrihen opinionet e AGJ mbi atë se nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në financat e organizatave buxhetore në fjalë.

III. STATUSI I REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT NGA VITET E MËHERSHME

Auditimi nga ZAGJ i pasqyrave financiare të Komunës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2006 ka rezultuar në 32 rekomandime të auditorit (detajet e të cilave janë paraqitur në tabelën më poshtë). Auditimi aktual ka përcaktuar se Komuna ende nuk i ka implementuar 11 rekomandime.

Të gjeturat	Rekomandimi	I implementuar Po/Jo
Sistemi i kontrollit të brendshëm – Dosjet e personelit		
<p>1. Me rastin e rishikimit të procedurave mbi evidencat e personelit kemi gjetur shumë mangësi në aspektin e kompletimit të dosjeve. Kjo çështje është diskutuar edhe me zyrtarët e Departamentit përkatës, dhe lidhur me gjendjen ekzistuese është arritur pajtueshmëri edhe me të audituarin.</p>	<p>ZAGJ rekomandon që të gjitha dosjet të kompletohen me dokumentacionin e mangët. Dosjet e personelit të mirëmbahen dhe përditësohen varësisht nga lëvizja e personelit (largimi i punëtorëve aktual apo pranimi i punëtorëve të rinj).</p>	<p>I pa implementuar</p>
Të hyrat vetjake		
<p>2. Me rastin e inkasimit të pagesave të taksave administrative nga qytetarët, ne kemi vërejtë se të gjitha inkasimet bëhen përmes një blloku dëftesash, ku nuk mund të kuptohet se çfarë lloj shërbimesh administrative janë kryer. Të hyrat ditore raportohen në total.</p> <p>3. Në rastin e testimit të plotësisë së të hyrave, në Departamentin e shëndetësisë, është shënuar rasti kur një dëftesë nuk është regjistruar të njëjtën ditë kur edhe është kryer shërbimi (shih Libri i protokollit prej 6069 deri 6102).</p> <p>4 Me rastin e ekzaminimit të të hyrave të krijuara nga Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Shërbimit Pronësor – juridik është vërejtë se janë lidhur disa kontrata për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të tokës ndërtimore në vendin e quajtur “Golesh “me qellim ndërtimi të lokaleve afariste “. Mbi 10 kontrata, secila me sipërfaqe prej 60 m2. janë dhënë në kohë zgjatje shfrytëzimi prej 30 vitesh.</p> <p>5. Në ekzaminimin i dosjeve (kërkesave) të qytetarëve për shërbime të kadastrit, gjeodezisë dhe pronës, në dosje nuk kemi gjetur kërkesat e qytetarëve, siç është rasti me dosjet nr. 06/03/06, 06/011/06, 06/060/06, 06/069/06, 06/74/06 dhe 06/81/06 . Në dosje janë gjetur vetëm raportet e bankës, ku qytetarët kanë bërë pagesën për shërbim. Në kontabilitet nuk ishin regjistruar dokumentet burimore, p.sh. Raporti i BPB.</p> <p>6. Sipas raportit numër 53/2006, deri më 24.01.2007 shuma e faturuar e tatimit në pronë është prej 489,204 € ndërsa prej tyre janë inkasuar 402,185 € , që do të thotë se shkalla e inkasimit është realizuar për 82,21 %.</p>	<p>ZAGJ i rekomandon menaxhmentit të komunës të vendos praktika më të përshtatshme të raportimit financiar të të hyrave. Raportet duhet të jenë të qarta dhe të plota përmes të cilave do të kuptohej baza e qartë e krijimit të të hyrave vetjake.</p> <p>Të gjitha inkasimet në kesh, në baza ditore duhet të transferohen në llogaritë bankare të komunës.</p> <p>Kuvendi Komunal duhet t’i përmbahet nenit 11 të Udhëzimit Administrativ nr. 2006/12 Udhëzimet e përfundimit të vitit</p>	<p>I pa implementuar</p>

Auditimi Financiar

Komuna e Malishevës për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

<p>7. Një pjesë e mirë e mbledhjes së tatimit në pronë është bërë nga inkasimet në terren, nga ana e zyrtarëve të caktuar. Paratë e mbledhura janë transferuar në llogarinë bankare. Shumat e mbledhura në të gatshme arrijnë kuotën deri në 248 € për person. Ne nuk u siguroam se tatimpaguesve u janë lëshuar dëshmi mbi kryerjen e pagesave.</p>		
<p>Shpenzimet -Pagesat nga Patty cash-i</p>		
<p>8. Tek pagesat nga Patty cash janë vërejtë disa pa rregullësi. Për të njëjtin shërbim, është faturuar në dy-tri fatura të ndara, që të mos tejkalohet kuota e pagesës mbi 100 € Rasti i tillë mund të ilustruhet me faturën e njejtë të ndarë në dy pjesë, e që përmban numrat e njejtë; serik 42/06 dhe 42/06 të operatorit ekonomik “ Kosovarja “. Të dyjat janë në vlera prej 70 € Pastaj, fatura me numër 59/06 është e datës 30/08/2006, kurse fatura me numër 61/06 është e datës 17/08/2006.</p> <p>9. Fatura nr. 779378 në shumën prej 36 € është paguar në emër të gjobës së komunikacionit. Pagesa ka qenë obligim i shoferit.</p> <p>10 Sipas kuponit nr. 024055 në vlerën 100 € janë blerë pije alkoolike. Kuponi nuk ka numër të biznesit dhe nuk dihet kush është blerësi i artikujve.</p>	<p>ZAGJ i rekomandon Departamentit të financave të komunës që t’i përmbahet me korrektësi Rregullave financiare dhe Udhëzimit të Thesarit-2, Shpenzimi i parave publike dhe LMFPF. nr. 2003/2.</p>	<p>I implementuar</p>
<p>Mallrat & shërbimet</p>		
<p>Prokurimet e kryera jashtë plani</p>		
<p>11. Pas rishikimit të procedurave të prokurimit, janë konstatuar pa rregullësi të shumta të cilat më hollësisht do të përshkruhen në vijim. 1. Kontrata nr. 39 në vlerën prej 184,373 € rruga Carrallukë – Lladrovç “ dhe kontrata nr. 50, lidhur me “ Punimet në asfaltin Mirushë – Gurbardh “ prej 159,620 € janë realizuar jashtë Planit vjetor të prokurimit.</p>	<p>ZAGJ rekomandon menaxhmentin e komunës që me korrektësi t’i përmbahet dispozitave të LPP.</p>	<p>I pa implementuar</p>
<p>Vonesat në pagesën e faturave</p>		
<p>12. Te kontrata nr.50, ” Punimi i asfaltit në rrugën MIRUSHË- GURBARDH “, në vlerën prej 159,620 € dhe kontrata nr.57, Ujës-jellësi për fshatin BARDH-BELLANICË “ në vlerën prej 32,812 € kemi vërejtë se operatorëve ekonomik nuk iu është bërë pagesa me kohë.</p>	<p>ZAGJ rekomandon Departamentin për buxhet dhe financa që t; i respektoj kërkesat ligjore që dalin nga Rregullat Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit-02 Shpenzimi i parave publike dhe LMFPF, kërkesa sipas të cilave organizatat buxhetore janë të obliguara që të gjitha faturat të paguhen në afatin brenda 30 ditësh nga dita e dorëzimit të faturës.</p>	<p>I paimplementuar</p>
<p>Përdorimi jo adekuat i kodeve</p>		
<p>13. Te disa kontrata, siç janë kontrata nr.57, “Punimi i ujës-jellësit në fshatin BARDH-BELLANICË “ në vlerën prej 32,812 € kontrata nr.32 “Punimi i gropave me asfalt në qytezën e Malishevës” në vlerë prej 9,912 € kontrata nr.39, “Asfaltimi i rrugës CARALLUKE - LLADROC” në vlerë 184,373 € si dhe kontrata nr. 50.”Punimi i asfaltit në rrugën “MIRUSHË- GURBARDH “, në vlerën prej 159,620 € janë paguar nga kode të ndryshme ekonomike dhe të projektit.</p>	<p>Rekomandohet menaxhmenti i komunës që t’i përmbahet me kujdes kodimit të nevojshëm të shpenzimeve.</p>	<p>I pa implementuar</p>
<p>14. Tek kontrata nr. 1, “ Ndërrimi i dritareve të drurit në dritare profili PVC, pagesa është bërë nga kodet e dy departamenteve; kodi i programit 17750 dhe kodi 92774. E njëjta pagesë është bërë nga dy kode</p>	<p>Të gjitha transaksionet financiare të regjistrohen në pajtim me kornizën e nxjerrë nga MEF për regjistrimin e shpenzimeve.</p>	<p>I paimplementuar</p>

Auditimi Financiar

Komuna e Malishevës për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

ekonomike : 31200 dhe 31130.		
Punët shtesë pa autorizimet e duhura		
15. Lidhur me kontratën nr. 53 që ka të bëjë me furnizim, ka pasur tejkalime të kontratës. Dy herë janë kërkuar aprovime për punët shtesë në APP dhe në dy rastet APP ka refuzuar kërkesat. Janë bërë pagesa të paligjshme për faturën nr. 04/07 të datës 26.10.2006 që ka të bëjë me kontratën e datës 24/10/2006.	ZAGJ rekomandon Departamentin e prokurimit dhe të financave që me saktësi t'i përmbahet LPP.	I implementuar
Mosrespektimi i kushteve të kontratës		
16.për kontratën Nr. 43 në vlerë 20,826 Euro” ndërtimi i stacionit elektrik në fshatin Shkarashnik” ne kemi vërejtur pasiguri mbi konstruksionet financiare. Sipas vendimit të Komitetit për Buxhet dhe Financa, Komuna ka vendosur të japë fonde për projektin deri ne 1/3 e kostos së kontraktuar që është 6,942 Euro. Në kontratën e prokurimit Komuna ka fondosur të japë fonde për projektin 14,598 Euro përderisa 6,228 Euro janë dhuruar nga PRK. Ne nuk kemi gjetur dëshmi se PRK ka paguar pjesën e saj të obligimeve. Vlera totale e kontratës që është paguar nga komuna është 20,875Euro.	Rekomandohet që komuna të ndjekë vendimin e Komitetit për Buxhet dhe Financa dhe dispozitat për marrëveshje që janë dakorduar me donatorët dhe komunitetet.	I implementuar
Inicimi i procedurave të prokurimit pa zotimin paraprak të fondeve		
17. Raste të mos përputhjeve me LPP janë vërejtë edhe lidhur me zotimet. Te kontrata e prokurimit nr. 56, që ka të bëjë me “ Furnizimin me inventar të shkollave, për vitin 2006-2007, sipas një Aktvendimi nr. 02/649 data 13.09.2006 janë aprovuar mjete në shumën prej 5,000 € ndërsa vlera e kontratës ka qenë 81,155 € Procedurat janë zhvilluar pa zotimin e fondeve. 18. Po ashtu, edhe tek kontrata nr. 52 në shumën prej 67,545 €nuk është bërë zotim paraprak.	I rekomandojmë Departamentit të prokurimeve të komunës që ti përmbahet nenit 8.2 te Ligjit mbi Prokurimin publik, që ka të bëjë me disponueshmërin e mjeteve.	I pa implementuar
Mospërputhjet me kriteret e tenderimit		
19. Në rastin e kontratës nr. 56 të datës 15/11/2006, komisioni i vlerësimit nuk ka respektuar kriterin e dhënies së kontratës operatorit ekonomikisht më të favorshem, por me kontratë është shpërblyer ofertuesi me çmim më të ulët.	Departamenti i prokurimit duhet të veproj në përputhje me dispozitat e ne ni t 50.2 LPP, nr. 2003/17.	I implementuar
Mospërputhje në mes të sasive të faturuara dhe të pranuar		
20 Artikujt e pranuar në bazë të faturës tatimore nr. 011131 të datës 27.11.2006 dhe faturës tatimore nr. 011132, të datës 27.11.2006 (Banka shkollore 63, karrika 248 dhe tabela 3) nuk përputhen me artikujt e pranuar sipas fletëdërgesës nr. 46/04, 50/06, 52/0651/06, 48/06, 47/06dhe 49/06. Sipas këtyre fletë dërgesave janë pranuar banka 55 copë., karrika 248 dhe tabela 3. Pesë banka shkollore janë paguar pa u pranuar fare.	ZAGJ i rekomandon menaxhmentit të rishikoj këtë rast dhe në të ardhmën të mos bëjë asnjë pagesë për mallrat që nuk janë pranuar.	I implementuar
Mospërputhje në mes çmimeve të faturuara dhe të		

<p>kontraktuara</p> <p>21. Tek kontrata e prokurimit nr.56, në vlerën prej 81,155 € çmimi kontraktues për artikullin tabela për shpallje është 75 € ndërsa në faturën nr.011131, i njëjti artikull është faturuar 130 € për copë. Në rastin konkret, 165 € janë paguar më shumë.</p>	<p>Rekomandohet Departamenti i financave dhe i prokurimit që të rishikoj rastin dhe në të ardhmën saktësisht t'u përmbahet dispozitave të kontraktuara të prokurimit.</p>	<p>I pa implementuar</p>
<p>Mospërputhje të njërive matëse të faturuara me njësitë e kontraktuara</p>		
<p>22. Te kontrata nr. 20, Furnizim me zhavorr të fraksionit 0,30 dhe 0,60 është gjetur se formularët sipas modulit të blerjes plotësohen me numra të ndryshëm që nuk korrespondojnë në mes veti.</p> <p>Te formulari - Kërkesë zotimi për blerje, numri i kërkesës për blerje është 47339, nr. zotimit 57402 dhe sasia 4512 m3 ndërsa, te formulari urdhër për pagesë numri i kërkesës për blerje 47625, numri i zotimit 60487 dhe sasia 4,511 m .</p> <p>23. Fatura nr. 22 e datës 29.09.2006 nuk e ka numrin e Urdhërblerjes e as numrat e fletëdërgesave të zhavorrit. Sipas dokumentit standard, figuron se sipas raportit të pranimit janë pranuar 4,512 m2 e jo m3.</p>	<p>I rekomandohet KK që formularët të plotësohen me numra që korrespondojnë në mes veti ashtu siç kërkojnë vetë formularët standard dhe të avancoj kontrollin e brendshëm.</p> <p>ZAGJ i rekomandon menaxhmentit të komunës që proceset e prokurimit t'i udhëheq në pajtim me kërkesat e LPP, si dhe kushtet kontraktuese me operatorët ekonomik t'i respektoj në tërësi. Rasti të rishikohet</p>	<p>I pa implementuar</p>
<p>Mospërputhje në mes sasive (materialit) të kontraktuar dhe materialeve të faturuara</p>		
<p>24. Marrëveshja nr. 14 : Asfaltimi i rrugës QARRLUGË-DRENAR-VERISHTË-BUJANË</p> <p>25. Faturës nr. 21064/710101 të datës 08.12.2005 në shumën prej 40,000 € e paguar më 09.12.2005 i mungon situatë e punëve të kryera.</p> <p>26. Faturës nr. 21002/710101 të dates 27.04.2006 në shumën prej 59,000 € e paguar më 05.05.2006 i është bashkangjitur situata e II e përkohshme e punëve ndërtimore të ekzekutuara. Te kjo situatë, sipas pikës 5, Punimi i mbushjeve në shtresa me material guror, operatori ekonomik ka faturuar 7000 m3 në shumën prej 31,500 € Sipas kontratës janë kontraktuar 700 m3 në shumën prej 3150 euro. Është paguar më tepër një diferencë prej 28,350 €</p> <p>27. Fatura nr. 21026/710101 e dates 12.07.2006 në shumë prej 36,600 € e paguar më 18.07.2006 i është bashkangjitur situata e III e përkohshme e punëve ndërtimore të ekzekutuara. Te kjo situatë, sipas pikës 5, Punimi i mbushjeve në shtresa me material guror operatori ekonomik ka faturuar edhe 7,072 m3 më shumë se sa kontrata, që kap shumen prej 31,826 € Fatura nr. 21027/710101 e datës 12.07.2006 në shumë prej 13,563 € e paguar më 18.07.2006 i është bashkangjitur situata IV e përkohshme. Te kjo situatë, sipas pikës 16, transporti i</p>	<p>ZAGJ rekomandon nivelin më të lartë të menaxhmentit të komunës që të rishikoj rastet se cilat janë rrethanat që kanë sjellë këto situatë dhe të propozoj masat për zgjidhjen e këtyre rasteve.</p> <p>Të rritet dhe forcohet shkalla e kontrollit të brendshëm në aspektin e prokurimeve, veçanërisht tek kontratat ndërtimore.</p>	<p>I pa implementuar</p>

<p>mallit guror për tampon dhe bankina me shpërndarje dhe ngjeshje b=7m operatori ekonomik ka faturuar 10,599.95 m3 në shumën prej 21,199 € Sipas kontratës janë kontraktuar 8584.8 m3 në shumë prej 17,169 € Diferenca më tepër për 4,030 €</p> <p>28. Fatura nr. 21028/710101 e dates 12.07.2006 në shumë prej 9,990 € e pagur me UOP, por të njëjtës i mungon data pagesës. UOP-së i është bashkangjitur situata V e përkohshme. Te kjo situatë, sipas pikës 18 punimi i shtresës lidhëse të asfaltit, bitumenit në gjendje të ngjeshur t=7vmcm, B=5 operatori ekonomik ka faturuar 1206.52 m2 në shumë prej 8,687 € Sipas kontratës janë kontraktuar 22484 m2 në shumë prej 161,885 € UOP-ja ka të regjistruar tjetër kod programor , pa kod projekti, tjetër kod ekonomik dhe funksional.</p> <p>29. Fatura nr. 21035/710101 e dates 26.07.2006 në shumë prej 50,000 € e paguar me 4.08.2006. Kësaj fature nuk i është bashkangjitur situata e përkohshme. Nuk mund të kuptohet se cilat punë janë paguar me 50,000 €.</p> <p>30. Fatura nr. 21049/710101 e datës 31.08.2006 në shumë prej 33,217 € e paguar më 24.10.2006. Kësaj fature nuk i është bashkangjitur situata përfundimtare. Me këtë faturë është ndaluar 10% në emër të garancionit të paraparë me kontratë që kap shumën prej 26,930 €</p>		
<p>Subvencionet</p>		
<p>31. Me UOP nr. 21869, numri referencës 16060346 dhe kodi burimor 21, një biznesi i janë paguar 1,000 € si mbështetje për ngritjen e një plantacioni të pemëve.</p> <p>Me rastin e procedimit të kësaj pagese, ne nuk kemi gjetur ndonjë kërkesë nga ana e biznesit, të cilit i është dhënë donacioni. Kërkesën në emër të biznesit e ka parashtruar Drejtori i Drejtoratit për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural.</p>	<p>I rekomandohet menaxhmentit të komunës që subvencionet për mbështetje të projekteve të kenë arsyetimin në kërkesat e qarta dhe programet e dorëzuara nga palët e interesuara.</p>	<p>I implementuar</p>
<p>Menaxhimi i pasurive</p>		
<p>32. Nuk ekziston një ndarje e mirë e detyrave. Zyrtari i pasurive është duke e ushtruar edhe punë tjera dhe punët që i përkasin menaxhimit të pasurive i kryen si punë sekondare. Zyrtari i pasurive menaxhon procesin e blerjes, regjistrimit dhe mirëmbajtjes së pasurive.</p>	<p>ZAGJ rekomandon menaxhmentin e komunës që në tërësi t'i zbatoj dispozitat e Udhëzimit administrativ, nr. 2005/11 mbi Menaxhimin dhe Regjistrimin e Pasurive Qeveritare.</p>	<p>I pa implementuar</p>

IV. FUSHVEPRIMI I AUDITIMIT

ZAGJ ka udhëhequr auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Malishevës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007. Komuna punon nën rregulloren e vetëqeverisjes së Komunave në Kosovë 2000/45, rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/54,2007/30 dhe statutin e Komunës.

Qëllimi kryesor i auditimit është që t'ia mundësojë ZAGJ dhënien e mendimit nëse pasqyrat financiare të Komunës, të paraqitura në Shtojcën I, japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë vitit të përfunduar më 31 Dhjetor 2007, si dhe në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) mbi “ Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) është përgjegjës për nxjerrjen e SNKSP. Saktësia dhe plotësia e pasqyrave financiare dhe shënimeve përcjellëse në Shtojcën I janë përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës.

Auditimi ynë i pasqyrave financiare të Komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007 është bërë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar mbi Standardet e Auditimit dhe Sigurimit. Bordi funksionon si organ për vendosjen e standardeve ndërkombëtare nën rrethanat e FNK. SNK themelojnë kornizën ndërkombëtare brenda të cilës ZAGJ performon punën e saj dhe mbulon çështjet si parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlersimet e rrezikut dhe përgjigjet në rreziqet e vlersuara, dëshmitë e auditimit, mbështetja në punët e tjerve, dhe konkluzionet e auditimit dhe raportimi.

V. MENDIMI I AUDITORIT

Baza për mohim të mendimit

Përmbledhja e çështjeve të rëndësishme të identifikuara përgjatë procedurave tona të auditimit që na shpion deri te mohimi i dhënies së mendimit tonë të auditorit janë paraqitur më tej në këtë pjesë. Të gjeturat dhe rekomandimet tona janë shqyrtuar në detaje në Pjesën VII: Të gjeturat kyqe të auditimit dhe rekomandimet.

A. Procesi i kontabilitetit dhe raportimit financiar

1. Shuma e donacioneve të pranuar të komunës gjatë vitit të përfunduar më 31 Dhjetor 2007, siq është raportuar në pasqyrat financiare, nuk janë të barazuar me të dhënat relevante të dhëna nga Departamenti i Thesarit në MEF dhe gjithashtu me ato të regjistruara ne sistemin e kontabilitetit të komunës. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë sigurit të arsyeshme mbi tërësinë dhe saktësinë e të hyrave dhe shpenzimeve të komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.
2. Komuna nuk ka bërë ndonjë shpalosje të asetëve fikse në pasqyrat financiare të vitit 2007 siq kërkohet nga udhëzimi administrativ 2007/08 i nxjerrë nga Njësia e Thesarit në MEF. Veç kësaj, komuna nuk mban regjistër ndaras për asetet fikse siq kërkohet nga udhëzimi administrative 2005/11. ne kemi marrë vetëm numërimin fizik të stoqeve të komunës me mangësi të shumta të identifikuara.

B. Plani dhe efektiviteti operativ i kontrolleve të brendshme

3. Duke u bazuar në rezultatet e procedurave të auditimit ne gjetëm të meta materiale në planifikimin dhe efektivitetin operativ të kontrolleve të brendshme të komunës veqanërisht për sa i përket mungesës së procesit të duhur të autorizimit në lidhje me shpenzimin e mallrave. Prandaj ne nuk ishim në gjendje të arrijmë siguri të arsyeshme mbi vlefshmërinë e këtyre shpenzimeve që janë njohur në pasqyrat financiare të komunë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.
4. Veç kësaj duke u bazuar në procedurat tona ne gjetëm se Komuna ka dështuar në vendosjen e procedurave efektive në departamentin e prokurimit në lidhje me menaxhimin e kontratave të furnizimit, pastaj pagesat ndaj furnizuesve dhe mbajtjen e shënimeve për detyrimet e pashlyera ndaj furnizuesve. Siq është shpalosur më detajisht në pjesën VII, për shkak të mosekzistimit të këtyre procedurave, ka rrezik të pagesave më të larta dhe të dështimit në shlyerjen e detyrimeve të kontraktuara.

C. Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret

5. Rastet në vazhdim të mos pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, të cilat janë shtjelluar detajisht në Pjesën VII: Të gjeturat kyçe të auditimit dhe rekomandimet, janë konsideruar të jenë të një rëndësie të veçantë:
- dështimi për të kërkuar dhe inkasuar gjobitjet në rastet e shmangies ose venesës së furnizuesve në shlyerjen e obligimit kontraktual;
 - ndryshimet ndërmjet mallrave dhe shërbimeve të kontraktuara dhe atyre që në të vërtetë janë blerë në terme të çmimeve dhe sasisë së tyre; dhe
 - inkasimi i disa të hyrave që nuk është i lejueshëm me para në dorë;

Duke marrë parasysh të mësipërmet, veprime të ndryshme ligjore dhe pretendime mund të pohohen në të ardhmen dhe prandaj ka një risk të gjobave dhe dënimeve shtesë që mund të ngarkohen kundër komunës. Në datën e lëshimit të këtij raporti rezultati i këtyre çështjeve nuk mund të përcaktohet me siguri të mjaftueshme dhe nuk ka pasur shpalosje adekuate për detyrimet kontingjente në pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007.

Mohimi i mendimit

Për shkak të egzistencës së pasigurive të shumta materiale dhe për shkak të rëndësisë së çështjeve të shqyrtuara në paragrafët paraprakë, ne nuk ishim në gjendje dhe nuk shprehim mendim mbi pasqyrat financiare të Komunës në pajtueshmëri me SNKSP "Raportimi Financiar nën Bazën e Kontabilitetit të Parasë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.

VI. ÇASJA E AUDITIMIT

Auditimi ynë i pasqyrave financiare të Komunës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2007, është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të lëshuara nga Bordi mbi Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (BSNAS). Bordi funksionon si një organ përcaktues i standardeve ndërkombëtare nën patronazhin e FNK. SNA vendosin kornizën punuese ndërkombëtare përbrenda së cilës ZAGJ kryen punën e saj dhe mbulon çështjet siq janë parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlersimi i rreziqeve dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlersuara, dëshmia e auditimit, mbështetja në punën e të tjerëve, si dhe konkluzionet dhe raportimet e auditimit.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive tona ne:

- Kemi rishikuar pasqyrat financiare të Komunës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2007;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të Komunës janë përgatitur në pajtueshmëri me SNKSP-të “Raportimi financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së gatshme”;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të zgjedhjes së mostrave sipas gjykimit dhe rastit, në zgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;

Të gjetura dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin, informatat dhe shpjegimet të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit. Ka të ngjarë që informata shtesë mund të kenë egzistuar, të cilat nuk na janë ofruar neve, dhe po të na ishin ofruar, mund të kishin ndryshuar të gjeturat.

Për sa i përket mendimit të auditorit të ZAGJ lidhur me pasqyrat financiare të Komunës, SNA definojnë kriteret specifike që përcaktojnë llojin e opinionit që mund të ipet. Mendimi i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i mendimit. Për shembull, ZAGJ mund të mos jetë në gjendje të japë një mendim të pakualifikuar kur egziston cilado nga rrethanat vijuese dhe sipas gjykimit të ZAGJ efekti i çështjeve është ose mund të jetë material për pasqyrat financiare:

(a) Kur ka kufizim të fushëveprimit të punës së auditorit; ose

(b) Kur ka mosmarrëveshje me menaxhmentin lidhur me pranueshmërinë e politikave të zgjedhura kontabël, metodën e aplikimit të tyre ose përshtatshmërinë e shpalosjeve të pasqyrave financiare.

Rrethanat e përshkruara në (a) mund të shpiejnë në mendimin e kualifikuar ose në mohimin e mendimit. Rrethanat e përshkruara nën (b) mund të shpiejnë në mendimin e kualifikuar ose në mendim të kundërt.

Një mendim i kualifikuar në përgjithësi shprehet kur ZAGJ konstaton se nuk mund të ipet një mendim i pakualifikuar, porse efekti i ndonjë mosmarrëveshje me menaxhmentin, ose kufizimi i fushëveprimit nuk është material dhe i përhapur sa të kërkojë dhënien e një mendimi të kundërt ose mohim të mendimit.

Mohimi i mendimit do të jepet atëherë kur efekti i mundshëm i kufizimit në fushëveprim është aq material dhe i përhapur sa që ZAGJ nuk ka mundur të siguroj dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit dhe rrjedhimish nuk mund të shpreh një mendim lidhur me pasqyrat financiare.

Një mendim i kundërt do të ipet kur efekti i mosmarrëveshjes është aq material dhe i përhapur në pasqyrat financiare për çka dhe ZAGJ konstaton se kualifikimi i raportit nuk është i përshtatshëm për të shpalosur natyrën e çorientuar dhe jo të plotë të pasqyrave financiare.

VII. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET KYQE TË AUDITIMIT

Në vazhdim janë të gjeturat kyqe të auditimit dhe rekomandimet që kanë rezultuar nga auditimi ynë i pasqyrave financiare të Komunës. Komentet e menaxhmentit në lidhje me secilën të gjetur dhe rekomandim janë në vazhdim të secilës pjesë së bashku me vlersimin tonë të komenteve të menaxhmentit. Komentet e menaxhmentit do të përfshihen në tërësi në Shtojcën 2.

A. Procesi i kontabilitetit dhe raportimit financiar

Të gjeturat # 1

Gjatë inspektimit të dokumentave burimore në lidhje me grantet e pranuar ne gjetëm se gjatë vitit 2007 Komuna ka pranuar grante në shumën totale prej EUR 302,000. Sipas Shënimit 13 të pasqyrave financiare, rendi Donacionet, totali i granteve të pranuar është EUR 375,000. Ndryshimi në vlerë EUR 73,000 është për shkak të donacioneve të pranuar në vitin 2006 nga një donator norvegjez, që në të vërtetë është raportuar në pasqyrat financiare të vitit 2007.

Rekomandimi

Ne i rekomandojmë menaxhmentit që të bëjë barazim të shpeshtë të të dhënave të tyre financiare me ato nga institucionet relevante, siq është Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Kjo do të sigurote me kohë korigjime të gabimeve të mundshme në procesimin e transaksioneve financiare relevante si dhe informata financiare të sakta dhe të vlefshme për përdoruesit e raporteve financiare të komunës.

Të gjeturat # 2

Komuna nuk ka bërë ndonjë shpalosje në lidhje me balancin dhe ndryshimet në asetet fikse në raportin financiar për vitin 2007. Veç kësaj, ne kemi kërkuar por nuk kemi marrë regjistrin e aseteve fikse. Ne kemi marrë vetëm numërimin fizik të stokeve të komunës ku shumë artikuj janë pa vlera.

Rekomandim

Menaxhmenti duhet të ndjekë Udhëzimin Administrativ 2005/11 mbi menaxhimin dhe regjistrimin e aseteve qeveritare.

Ne i rekomandojmë menaxhmentit të dizajnojë dhe implementojë procedura të përshtatshme që do të kërkonin:

- Regjistrime pronësore të detajuara për secilin asset fiks
- Caktimin dhe vënien e numrit identifikues pronësor për secilin asset.
- Politikën e Kapitalizimit nën të cilën pagesat më të vogla se një shumë specifikuar në Euro do të paraqiteshin si shpenzim.

Për më tepër dhe si minimale, libri i pronës duhet të përmbajë informatat në vazhdim për secilin asset fiks:

- Datën e përvetësimit

- Vendndodhjen
- Numrin e vënë nga komuna (numri etiketues)
- Numri serik
- Përshkrimi dhe funksioni
- Baza e kostos
- Detaje të zhvlersimit, përfshirë metodat e llogaritjes për qëllime tatimi dhe raportimi financiar
- Koha e parashikuar e përdorimit
- Kostoja e mirëmbajtjes pas datës së blerjes
- Data e heqjes
- Burimi financues
- Numri referues i dëftesës së shpenzimit (CPO #).

B. Dizajni dhe efektiviteti operativ i kontrolleve të brendshme

Të gjeturat # 3

Nga inspektimi i dokumenteve burimore në lidhje me prokurimin e drurit për nxehje të bërë nga departamenti i arsimit në shumë EUR 14,562 ne nuk gjetëm ndonjë dëshmi se personi përgjegjës ka kryer procedurat e duhura të autorizimit për miratimin e vlefshmërisë dhe plotësisë së prokurimit. Ne nuk arritem të identifikojmë personin i cili ka nënshkruar si pranues dhe forma e dorëzimit nuk është vëlosur nga institucioni (shkolla) që ka pranuar furnizimin.

Rekomandim

Ne i rekomandojmë menaxhmentit që saktësisht të implementojë autorizimin për të gjitha dokumentet në lidhje me transaksionet e prokurimit duke caktuar personat e duhur përgjegjës.

Veç kësaj, komuna duhet të sigurojë që procedurat e mjaftueshme monitoruese të implementohen për sa i përket sasisë dhe cilësisë së furnizimeve.

Të gjeturat # 4

Duke u bazuar në inspektimin e shpenzimeve që kanë ndosur gjatë vitit 2007 ne gjetëm mungesë apo mangësi të dokumentacionit mbështetës, siq është:

- Për pagesën në vlerë EUR 6,776 në lidhje me ndërtimin e rrugës, që i është bërë furnizuesit OE Eskavatori, ne nuk na është dhënë fatura apo kontrata, që duhet të mbështesë pagesat;

Rekomandimi

Ne i rekomandojmë menaxhmentit të komunës të implementojë procedura adekuata për pagesat të cilat sigurojnë se dokumentet në vazhdim i janë bashkangjitur secilës nga pagesat e bëra: Kontrata, Fatura e aprovuar nga personi i autorizuar, dëshmi të tjera shtesë se mallrat dhe shërbimet në të vërtetë janë pranuar/kryer.

C. Pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret

Të gjeturat # 5

Duke u bazuar në ekzaminimin e implementimit të afateve dhe kushteve kontraktuese të prokurimit, ne gjetëm raste ku organet e autorizuara të komunës kanë dështuar në kërkimin dhe inkasimin e pagesave të gjobitjeve për shkak të vonesave të furnizuesve në shlyerjen e obligimit të tyre. Këto raste janë në vazhdim:

- Ndërtimi i rrugës Bellanice Ngucat, Bardh kontrata # 71;
- Ndërtimi i kanalizimit në lagjen Limaj, Begaj dhe Hazrolli kontrata # 64.

Rekomandimi

Ne i rekomandojmë menaxhmentit të Komunës që saktësisht të ndjekë kushtet e kontraktuara dhe të ngarkojë gjoba për moskompletimin e punë në baza kohore.

Veç kësaj, menaxhmenti duhet të monitorojë nga afër implementimin e projektit për t'u siguruar se puna po përmbushet sipas marrëveshjes.

Të gjeturat #6

Duke u bazuar në inspektimin e shpenzimeve që janë bërë gjatë vitit 2007 në lidhje me departamentin e shëndetësisë ne gjetëm një pagesë që i është bërë furnizuesit të barnave në vlerë EUR 2,100. Sipas kontratës me furnizuesin vlera është EUR 2,000.

Ndryshimi ndërmjet pagesës së bërë dhe asaj të kontraktuar është për shkak të ndryshimit ndërmjet çmimeve të kontraktuara dhe atyre të aplikuara.

Rekomandimi

Ne i rekomandojmë Komunës që saktësisht të aplikojë afatet dhe kushtet e përcaktuara në kontratën e nënshkruar.

Të gjeturat #7

Komuna zakonisht i inkason me para në dorë të gjitha të hyrat. Sipas rregullores të gjitha të hyrat që janë mbi EUR 10 duhet të inkasohen përmes llogarisë bankare dhe pastaj të transferohen në llogarinë e thesarit.

Rekomandim

Duke i'u referencuar të gjeturave të mësipërme mbi inkasimin e të hyrave me para në dorë ne i rekomandojmë menaxhmentit që saktësisht të aplikojë dispozitat në vazhdim:

- Nenin 15.1 dhe 15.2 nga Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 2003/2, dhe
- Neni 9.3 nga Rregulloret Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit – Shpenzimi i Parasë Publike 02/2006.

Shtojcë I

Komuna e Malishevës

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor
2007

Nr. i të gjeturës	Komentet e Menaxhmentit të Komunës	Komentet e Auditorit														
